

U D H Ë Z I M
Nr.45, datë 8.6.2001

**PËR DISA KRITERE TË PARAQITJES SË KANDIDATËVE PËR DEPUTET DHE
PËRLLOGARITJEN E NDARJES SË MANDATEVE PLOTËSUESE**

Në mbështetje të neneve 68 dhe 153 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, të nenit 2 pika 4, 18, 66, 76, 77 dhe 78 të ligjit nr. 8609, datë 8.5.2000 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

U D H Ë Z O N :

Për zbatimin e ligjit gjatë procesit parazgjedhor dhe zgjedhor dhe për njësimin e praktikave zgjedhore, lidhur me kriteret e paraqitjes së kandidatëve të pavarur dhe përlllogaritjen e ndarjes së mandateve plotësuese të vepohet si vijon :

1. Në kuptim të nenit 2 pika 4 të Kodit Zgjedhor, me “kandidat i pavarur” do të kuptohet ai kandidat për deputet në zonën njëemërore që nuk mbështetet nga asnjë parti politike ose koalicion partish, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi.

2. Me “mbështetje” të kandidatit të pavarur do të kuptohet:

a) përzgjedhja ose mbështetja zyrtare e kandidatit të pavarur që rezulton nga vendime, deklarime dhe qëndrime publike të organeve ose drejtuesve dhe forumeve të partive politike, grupimeve ose koalicioneve me vendim të forumeve të tyre drejtuese (këshill kombëtar, kongres);

b) mbështetja publike nga parti ose koalicione nëpërmjet posterave me siglën e partive, sloganin e tyre, propagandës, tubimeve ose financimeve;

c) funksionari që në administratën shtetërore mban ose kryhen funksione politike;

d) funksionari që në një parti politike mban funksione të larta drejtuese.

3. Përveç rasteve të parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij udhëzimi, çdo kandidat për deputet në zonat njëemërore që merr pjesë në zgjedhje ka të drejtë të rikonsiderojë pozicionin e tij ose pranon të mbështetet nga një parti ose koalicion politik. Gjithashtu, çdo subjekt politik, që merr pjesë në zgjedhje, ka të drejtë të rikonsiderojë mbështetjen e tij për kandidatët të cilët ajo mbështet në zonat njëemërore. Në këtë rast, kandidati ose subjekti që merr pjesë në zgjedhje ka të drejtë që, deri përpara datës së zgjedhjeve, të depozitojë një deklaratë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ku të kërkojë ndryshimin e këtij qëndrimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
ILIRIAN CELIBASHI